



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 4-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27.06.2022, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 14,<sup>00</sup>

#### Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
4. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Zoran Cirkovic, anëtar
8. Ana Guciq, anëtare

#### Të tjerë prezent

1. Latif Ramadani, DBF
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
3. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Fisnik Dida, OSBE
5. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

### R E N D I T E

1. Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 2 dhe 3-të e Komitetit për Komunitete
2. Informatë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025
3. Raporti i ZKKK-së
4. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimitisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

## **I**

### **1.Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 2 dhe 3-të e Komitetit për Komunitete**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstrakteve nga mbledhja 2 dhe 3-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimitisht votoi.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

## **II**

### **Informatë nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi ,ia kaloi fjalën Latif Ramadani nga DBF -së, i cili në pika të shkurta i njoftoi rreth rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Zoran Cirković,tha se a është i detalizuar ky projekt dhe kur pritet të metalizohet.

Latif Ramadani, tha se ky është vetëm korniza e parë ,ndërsa në shtator pritet të detalizohet

Shahadije Dragaçina tha se gjatë dëgjimeve buxhetore ne kemi dhënë disa propozime dhe me sa e kam parë, asnjë nga propozimet që i kemi dhënë ne nuk është përfshi në kornizë.

Latif Ramadani, tha se disa projekte do të përfshihen ne pjesën e dytë kur të vjen buxheti në shtator. Pasi që ende nuk i kemi marrë kufijtë përfundimtar.

Idajet Garip, tha se në Janjevë aty ku banojnë komuniteti Rom, ka nevojë për investime ,si disa rrugica, ndriçim publik,e të tjera të përfshihen ne buxhet.

Latif Ramadani, tha se në buxhet do të përshihen të gjitha ato kërkesat që janë më të nevojshme.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

### III

#### Raporti i ZKKK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi ,i'a kaloi fjalën Lidija Jovanovic nga ZKKK-së, e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Raportit të punës së ZKKK-së, ku tha se kemi vazhduar me aktivitete të tona të përgjithshme si dhe disa trajnime të ndryshme. Ne si ZKKK, kemi marrë informatë për zjarrëvënje në Medvec ndërsa kur jemi dal në teren e kemi parë që vetëm një dritare ka qenë e thyer.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Gentianë Hoxhaj, tha se në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar një raport për mbarvatjen e mësimit në shkollat ku mësojnë komunitetet.

Zoran Cirković,ne kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar për një raport të zgjeruar, Ne kemi biseduar me drejtoreshën e shkollës “Vëllëzërit Aksiq” lidhur me shkollën ne Lipjan dhe paralelet e ndara në Grackë dhe Rubofc, ku nga DKA kemi marrë disa materiale higjienike, material shpenzues për zyrë,dhe disa tjera, Dhe presim bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Pastaj u kalua në pikën të ndryshme.

### IV

#### Të ndryshme

Ana Guciç, tha se, në Janjevë ne disa vende janë disa plepa të cilët sa herë që ka erëra ato janë të rrezikshme për banorët e Janjevës dhe nuk e di se kujt duhet t'i drejtohem që ata plepa të prehen. Unë e kam lajmëruar policinë por ata me kanë thënë se nuk mund të hyjmë aty pasi që ka shtëpi shumë afër. Kërkoj ndihmën tuaj.

Zoran Cirković, tha se ne i kemi pas festat tona dhe kemi kërkuar të pastrohen varrezat dhe e kam thirr nënkryetarin dhe në Grackë dhe Lipjan janë pastruar varrezat,ndërsa ne Rubovc janë pastruar nga vet banorët.

Ne Grackë është një pronë publike e cila duhet të mirëmbahet nga komuna pasi që po paraqet rrezik për banorët e asaj pjese nga gjarprinjtë dhe insektet.

Skender Bikliqi, tha se edhe unë kam për t'i ngritur disa çështje e para pastrimi i varrezave nuk e di apo funksionon pasi që në Janjevë, nuk janë pastruar asnjëherë varrezat dhe ato po mirëmbahen nga banorët. Dhe kërkoj që kjo të merret parasysh.

Gentianë Hoxhaj ,tha se do të ishte mirë që zyra e informimit të jetë edhe ne mbledhjen e Komitetit për Komitete, pasi që në të gjitha komitetet tjera po postohen shkrime në faqe për takimet që po mbahen ndërsa në këtë komitet asnjëherë.

Lulzim Qerimi, tha se ne jemi këtu për çdo kërkesë tuajën, E para sa i përket shkollave, ne shkollën” Ismail Luma” sipas informatave të drejtorit të shkollës e kanë braktisë shkollën diku 16 nxënës, dhe unë se bashku me asamblesitin nga radhët e komitetit ashkali jemi marrë me këtë çështje kemi biseduar me prindërit e tyre me ditë cila është arsyeja qe ata e kanë ndërruar mësimin. Sa i përket varrezave është kompania që i pastron dy herë në vit ndërsa për pronën publike në Grackë të cilën e përmendi Zorani nuk e di çka të them. Sa i përket atyre plepave do të diskutoj pas mbledhjes me përgjegjësit dhe do të mundohemi të bëjmë një zgjidhje.

Zoran Cirkovic, tha se sa i përket subvencioneve të ZLKK-së është mirë të ndihmohet një grua në Grackë të cilën e kemi përmend para disa seancave dhe ajo tani e

ka rregulluar dokumentin e indetifikimit.

Ledia Jovanovic, tha se është një komision që i shikon të gjitha kërkesat dhe ai komision vendos në bazë të kushteve të cilat i plotësojnë kërkuuesit.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15<sup>15</sup>.

**Ekstraktin e hartoi**

**Behar Aliu**

**Kryesuesi i Komitetit**

**Skender Bikliqi**